

**SHPALLJE PËR LEVIZJE PARALELE,
NGRITJE NË DETYRË,
PRANIM NGA SHËRBIMI CIVIL
NË KATEGORINË E MESME DHE TË ULËT DREJTUESE**

Në zbatim ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Kreu IV dhe V “Pranimi në Shërbimin Civil” dhe “Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” i ndryshuar, si dhe Planit Vjetor të Rekrutimeve 2025, Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, shpall Procedurën e lëvizjes paralele dhe/ose ngritjes në detyrë dhe/ose pranim nga shërbimi civil për pozicionin:

- **1 (një) - “Drejtor i Drejtorisë së Studimeve”, në ISKK.**
- Kategoria e pagës II-I.

Pozicioni më sipër i ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende një pozicion është vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për procedurat (lëvizje paralele, ngritje në detyrë, pranim nga shërbimi civil) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e Dokumenteve:	Shih procedurat përkatëse
15.09.2025	Lëvizja paralele
19.09.2025	Ngritje në detyrë
19.09.2025	Pranim nga shërbimi civil

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin më sipër është:

Misioni i Drejtorisë: Realizimi i një serie projektsh kërkimore dhe studimore, krijimi i një arkive audio-vizuale me dëshmi të mbijetuarve, realizimi i një serie botimesh, dhe realizimi i

aktiviteteve me natyrë edukative, informuese dhe sensibilizimi publik mbi diktaturën komuniste në Shqipëri, të cilat janë në përputhje me misionin e ISKK.

Qëllimi i pozicionit të punës: Drejtori i Drejtorisë së Studimeve përgjigjet tek Drejtori Ekzekutiv për ideimin, organizimin e punës dhe implementimin e aktiviteteve me natyrë studimore, dokumentuese, dëshmuuese, arsimore, sensibilizuese dhe atyre të informimit publik të ISKK, sipas përshkrimit të pozicionit të punës të përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të ISKK për Drejtorinë e Studimeve

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin konsiston në këto detyra:

- a. Organizon dhe koordinon punën brenda Drejtorisë.
- b. Harton plane pune të Drejtorisë së Studimeve.
- c. Përcakton objektivat afatshkurtra dhe afatgjata të aktiviteteve të Drejtorisë së Studimeve
- d. Monitoron hap pas hapi punën e specialistëve të Drejtorisë së tij dhe raporton periodikisht tek Drejtori Ekzekutiv.
- e. Orienton dhe i ofron asistencë këshillimore specialistëve të Drejtorisë së Studimeve në projektet e tyre.
- f. Udhëheq punën në projekte individuale dhe në grup të përcaktuara për Drejtorinë e Studimeve.
- g. Prezanton punën e tij dhe të ISKK në aktivitete akademike, aktivitete arsimore dhe media, brenda dhe jashte vendit.
- h. Bashkëpunon me Drejtorin Ekzekutiv dhe drejtuesit e drejtorive të tjera, për hartimin e politikave të këtij institucioni: projektet afatgjata dhe afatshkurtra, prioritetet dhe buxhetin përkatës.
- i. Në bashkëpunim me Drejtorin Ekzekutiv, përgatit projekt-propozime për financim dhe vë kontaktet me donatorët dhe partnerët e tjerë.
- j. Vlerëson rezultatet e punës së nëpunësve të kësaj Drejtorie, performancën dhe sjelljen profesionale.
- k. Merr pjesë në hartimin e raporteve periodike dhe vjetore të ISKK.
- l. Planifikon dhe harton planin strategjik për realizimin e aktiviteteve të Drejtorisë sipas objektivave vjetore dhe afatgjata.
- m. Identifikon nevojat e kësaj Drejtorie dhe analizon kapacitetet e saj në varësi të objektivave të synuara.
- n. Mbikëqyr të gjithë punën e stafit të Drejtorisë, për realizimin në kohë dhe me cilësi të objektivave të synuara.
- o. Raporton ngjarjet dhe aktivitetet tek eprori.
- p. Zbaton planin e përgjithshëm vjetor ose projekte të tjera të planifikuara nga ISKK.

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

Kushtet e përgjithshme që duhet të plotësojë cdo kandidat në procedurën e konkurimit publik:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejon të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore;

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda të njëjtës kategori për të cilën aplikon ;
- të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- të ketë të paktën vlerësimin e fundit pozitiv “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojë minimalisht “Master Shkencor” në shkenca sociale dhe humane. Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet vërtetimi i njohjes nga MASR.
- Të ketë jo më pak se 5 vjet eksperiencë pune , 3 nga këto në pozicione drejtuese
- Të zotërojë në nivel mesatar gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.
- Të njohë periudhën e komunizmit dhe natyrën e punës së ISKK.
- Të zotërojë njohuri të mira historike dhe njohuri të përgjithshme.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi.
- Të zotërojë aftësi organizimi të punës.
- Të plotësoj kërkesat e veçanta të nenit 18 të ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010 **PËR INSTITUTIN E STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI** i cili shprehet se : *(Nëpunësit dhe punonjësit e institutit e të arkivit duhet të jenë persona që gëzojnë besueshmëri. Për qëllimet e këtij ligji, i besueshëm është çdo person, i cili ka mbushur moshën madhore përpara datës 8 dhjetor 1990 dhe nuk ka qenë:*
 - a) anëtar ose kandidat i PKSH-së a PPSH-së;
 - b) i shkolluar ose nuk ka bërë kualifikime në shkollat e larta politike të sigurimit ose mbrojtjes të Shqipërisë a të vendeve të Traktatit të Varshavës;
 - c) funksionar i sistemit komunist, pjesëtar i organeve të diktaturës komuniste apo bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit;
 - ç) anëtar ose bashkëpunëtor i shërbimeve inteligjente të vendeve të Traktatit të Varshavës)

Përbëjnë avantazh:

- Studimet në fushën e historisë
- Ekperience pune ne institucione ose entitete qe trajtojne të shkuarën komuniste.
- Njohuri të gjuhes anglese në nivelin C1
- Të zotërojë doktoraturë.
- Mesatare mbi 8.
- Individë që në portofolin e tyre kanë punime shkencore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Zyrës së protokollit të Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit , ku ndodhet pozicioni për të cilin ata dëshirojnë të aplikojnë, dokumentet si më poshtë:

- 1) jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në lidhjen <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- 2) fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- 3) fotokopje të librezës së punës (të gjithë faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- 4) fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- 5) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- 6) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- 7) letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
- 8) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- 9) një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit;
- 10) aktin e emërimit si nëpunës civil;
- 11) të dorëzojnë dokumentet e parashikuara në pikën 1.1.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 15.09.2025, në Zyrën e Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, me adresë: Rruga e Saraçve , te Selvia” (Pallati përballë supermarket Spar, Kati 2) , Tiranë.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **18.09.2025**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore (Njësia Përgjegjëse) e Zyrës së ISKK, ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, si dhe në faqen zyrtare www.iskk.gov.al, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia Përgjegjëse e institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Ligji nr.10242, datë 25.02.2010 “Për Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”.
- Ligjin nr. 45/2015 për të “Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Njohuritë mbi ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar) dhe aktet nën ligjore;
- Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
- Ligjin nr.9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike.”
- Ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, “ Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

- Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.
- Ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", i ndryshuar
- Njohuri rreth Rregullores së Brendshme të ISKK.

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen nga Komiteti i Pranimit për Lëvizje Paralele (KPLP) i ngritur në ISKK, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës së strukturuar me gojë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pikë, të cilat ndahen përkatësisht:

- **kandidatët do të vlerësohen për përvojën**, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.
- **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**
 - a- njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
 - b- eksperiencën e tyre të mëparshme;
 - c- motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015 "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur" të Departamentit të Administratës Publike <http://dap.gov.al/> në lidhjen <http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>.

Komisioni në përfundim të vlerësimit njofton individualisht kandidatët që kanë konkuruar për rezultatin e tyre. Kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankim me shkrim në Komitetin e Pranimit për Lëvizje Paralele për rezultatin e vlerësimit brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual mbi rezultatin. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit. Komisioni brenda 24 (njëzetë e katër) orëve pas përfundimit të procedurave të ankimit për zgjedh kandidatin, i cili renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia Përgjegjëse e ISKK do të shpallë fituesin në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" si dhe në faqen zyrtare www.iskk.gov.al. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

2- NGRITJE NË DETYRË

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende është pozicion vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Këtë informacion do ta merrni në faqen e ISKK-së, pas datës 26/09/2025.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin institucion apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet e përgjithshme që duhet të plotësojë cdo kandidat në procedurën e konkurimit publik:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejon të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë dënues me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore;

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- a) të jetë nëpunës civil i konfirmuar, në kategorinë e ulët drejtuese, në rastin e kandidatëve që aplikojnë për procedurën ngritje në detyrë;
- b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi të vërtetuar me një dokument nga institucioni;
- c) të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”, në rastin e kandidatëve që aplikojnë për procedurën ngritje në detyrë;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojë minimalisht “Master Shkencor” në shkenca sociale dhe humane. Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet vërtetim i njohjes nga MASR.
- Të ketë jo më pak se 5 vjet eksperiencë pune , 3 nga këto në pozicione drejtuese
- Të zotërojë në nivel mesatar gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.
- Të njohë periudhën e komunizmit dhe natyrën e punës së ISKK.
- Të zotërojë njohuri të mira historike dhe njohuri të përgjithshme.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi.
- Të zotërojë aftësi organizimi të punës.

- Të plotësoj kërkesat e veçanta të nenit 18 të ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010 *PËR INSTITUTIN E STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI* i cili shprehet se : (Nëpunësit dhe punonjësit e institutit e të arkivit duhet të jenë persona që gëzojnë besueshmëri. Për qëllimet e këtij ligji, i besueshëm është çdo person, i cili ka mbushur moshën madhore përpara datës 8 dhjetor 1990 dhe nuk ka qenë:

- a) anëtar ose kandidat i PKSH-së a PPSH-së;
- b) i shkolluar ose nuk ka bërë kualifikime në shkollat e larta politike të sigurimit ose mbrojtjes të Shqipërisë a të vendeve të Traktatit të Varshavës;
- c) funksionar i sistemit komunist, pjesëtar i organeve të diktaturës komuniste apo bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit;
- ç) anëtar ose bashkëpunëtor i shërbimeve inteligjente të vendeve të Traktatit të Varshavës)

Përbëjnë avantazh:

- Studimet në fushën e historisë
- Ekperience pune ne institucione ose entitete qe trajtojnë të shkuarën komuniste.
- Njohuri të gjuhës anglese në nivelin C1
- Të zotërojnë doktoraturë.
- Mesatare mbi 8.
- Individë që në portofolin e tyre kanë punime shkencore.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- 1) jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në lidhjen <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- 2) fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor) dhe listës së notave. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- 3) fotokopje të librezës së punës (të gjithë faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- 4) fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- 5) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- 6) vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- 7) letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
- 8) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- 9) një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit;
- 10) aktin e emërimit si nëpunës civil;
- 11) të dorëzojnë dokumentet e parashikuara në pikën 2.1.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 19.09.2025, në Zyrën e Sekretarise/Protokollit të Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të komunizmit , me adresë: Rruga e Saraçve , te Selvia” (Pallati përballë supermarket Spar, Kati 2) , Tiranë.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e ISKK-së duke filluar nga data: **26/09/2025**.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore (Njësia Përgjegjëse) e ISKK, ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” si dhe në faqen zyrtare www.iskk.gov.al, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit (Njësia Përgjegjëse), ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit. Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Ligji nr.10242, datë 25.02.2010 “Për Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”.
- Ligjin nr. 45/2015 për të “Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Njohuritë mbi ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil" (i ndryshuar) dhe aktet nën ligjore;
- Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
- Ligjin nr.9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike.”
- Ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, “ Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.
- Ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", i ndryshuar.
- Njohuri rreth Rregullores së Brendshme të ISKK.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatet do të vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit në ISKK, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar, vlerësimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është 100 pikë

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë;
- b-intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015 të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al në lidhjen <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>.

2.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia Përgjegjëse e ISKK, do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” si dhe në faqen zyrtare www.iskk.gov.al. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë, në këtë procedurë, do të marrin informacion për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;

-për datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi.

*Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e ISKK-së duke filluar **nga data 26/09/2025 e në vijim**.*

3- PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës ngritjes në detyrë, rezulton se ende ky pozicion është vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nga jashtë shërbimit civil.

Këtë informacion do ta merrni në faqen e ISSK-së, pas datës **26/09/2025**.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë kandidatë të cilët plotësojnë kërkesat për vendin e lire nga jashtë shërbimit civil.

Kushtet e përgjithshme që duhet të plotësojë cdo kandidat në procedurën e konkurimit publik:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejon të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojë minimalisht “Master Shkencor” në shkenca sociale dhe humane. Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet vërtetimi e njohjes nga MASR.
- Të ketë jo më pak se 5 vjet eksperiencë pune ,3 nga këto në pozicione drejtuese.
- Të zotërojë në nivel mesatar gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.
- Të njohë periudhën e komunizmit dhe natyrën e punës së ISKK.
- Të zotërojë njohuri të mira historike dhe njohuri të përgjithshme.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi.
- Të zotërojë aftësi organizimi të punës.
- Të plotësoj kërkesat e veçanta të nenit 18 të ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010 *PËR INSTITUTIN E STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI* i cili shprehet se : (Nëpunësit dhe punonjësit e institutit e të arkivit duhet të jenë persona që gëzojnë besueshmëri. Për qëllimet e këtij ligji, i besueshëm është çdo person, i cili ka mbushur moshën madhore përpara datës 8 dhjetor 1990 dhe nuk ka qenë:
 - a) anëtar ose kandidat i PKSH-së a PPSH-së;
 - b) i shkolluar ose nuk ka bërë kualifikime në shkollat e larta politike të sigurimit ose mbrojtjes të Shqipërisë a të vendeve të Traktatit të Varshavës;
 - c) funksionar i sistemit komunist, pjesëtar i organeve të diktaturës komuniste apo bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit;
 - ç) anëtar ose bashkëpunëtor i shërbimeve inteligjente të vendeve të Traktatit të Varshavës)

Përbëjnë avantazh:

- Studimet në fushën e historisë
- Ekperience pune ne institucione ose entitete qe trajtojnë të shkuarën komuniste.
- Njohuri të gjuhës anglese në nivelin C1
- Të zotërojë doktoraturë.
- Mesatare mbi 8.
- Individe që në portofolin e tyre kanë punime shkencore.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- 1) jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në lidhjen <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>.
- 2) fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor) dhe listës së notave. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- 3) fotokopje të librezës së punës (të gjithë faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- 4) fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- 5) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- 6) vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- 7) letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
- 8) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- 9) një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit;

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës **19.09.2025, në Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit me adresë: Rruga e Saraçve , te Selvia” (Pallati përballë supermarket Spar, Kati 2) , Tiranë.**

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimi në shërbimin civil , do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj procedurë:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e ISKK-së pas datës **26/09/2025**.

3.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore (Njësia Përgjegjëse) e ISKK, ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” si dhe në faqen zyrtare www.iskk.gov.al listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë, kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit (Njësia përgjegjëse), ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit. Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

3.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me njohuritë mbi:

- Ligji nr.10242, datë 25.02.2010 “Për Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”.
- Ligjin nr. 45/2015 për të “Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Njohuritë mbi ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil" (i ndryshuar) dhe aktet nën ligjore;
- Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
- Ligjin nr.9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike.”
- Ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
- Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.
- Ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", i ndryshuar.
- Njohuri rreth Rregullores së Brendshme të ISKK.

3.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatet do të vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm Pranimit në ISKK, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar, vlerësimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pikë.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c- jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezulttit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al në lidhjen http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015](http://www.dap.gov.al/në_lidhjen_http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015).

3.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia Përgjegjëse e Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” si dhe në faqen zyrtare www.iskk.gov.al . Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Kandidatët fitues janë ata që renditen të parët nga kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve). Njësia përgjegjëse njofton individualisht kandidatët që kanë konkurruar për rezultatin e tyre brenda 24 (njëzetekatër) orëve nga dita që Komiteti i njofton vendimin e tij. Kandidati ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim në Komitetin e Përhershëm të Pranimit për rezultatin e pikëve brenda

3 (tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual për rezultatin e vlerësimit. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data përfundimit të afatit të ankimit.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia Përgjegjëse e Institutit e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit , do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” si dhe në faqen zyrtare www.iskk.gov.al . Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil , do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj procedurë:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e ISKK-së pas datës 26/09/2025.

Njësia Përgjegjëse